



UNIVERSITETI I PRISHTINES
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush Ndertesitë e Rektoratit, 0000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 530
Date: 08/04/2025

RAPORTI I VLERËSIMIT PËR DORËSHKRIMIN E PUNIMIT TË DIPLOMËS SË MASTER-it

Fakulteti	i Inxhinierisë Mekanike
Departamenti/Programi	Komunikacionit/Komunikacion Rrugor
Projektpropozimi	"Analiza dhe modelimi i kërkesës për udhëtime në qytetin e Prishtinës".
Kandidati	Bsc. Amisa Bejta
Mentori	Prof.Ass.Dr. Ramadan Duraku
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e fakultetit	Datë: 25/07/2024 Vendimi me nr.: 1185/2-2, Datë: 25/07/2024

Vlerësimi i dorëshkrimit:

Në bazë të vendimit të Dekanit të Fakultetit, nr. 1185/2-2, Datë: 25/07/2024 është formuar komisioni me këtë përbërje:

1. Prof. Ass.Dr.Gëzim Hoxha, kryetar,
2. Prof.Ass.Dr. Ramadan Duraku, mentor,
3. Prof. Ass.Dr.Arlinda Alimehaj Rrecaj, anëtar.

për vlerësimin e punimit Master me titull "Analiza dhe modelimi i kërkesës për udhëtime në qytetin e Prishtinës" të kandidatës BSc.Amisa Bejta .

Pas kontrollimit të punimit të lartpërmendur Komisioni jep këtë:

RAPORT

Punimi me titull "Analiza dhe modelimi i kërkesës për udhëtime në qytetin e Prishtinës", është hartuar në 8 kapituj dhe është ilustruar përmes 63 figurave dhe 11 tabelave.

Në kapitullin e parë - Hyrja, paraqet pjesën kyçe të hulumtimit dhe të shfrytëzimit të dhënave si dhe hulumtimin dhe ndërtimin e modelit mikroskopik lidhur me modelimin e trafikut/transportit aplikimin e softuerit PTV Visum.

Në kapitullin e dytë - Përshkrimi i Gjendjes Ekzistuese Gjendja aktuale në kryeqytetin tonë është mjaft alarmuese pasi që sa vjen e bëhet edhe më e vështirë jetesa dhe qarkullimi i trafikut, duke marrur parasysh që këto vitet e fundit ka pasur shumë rritje të disa pjesëve

të qyteti që ka ndikuar mjaft shumë në rrjedhën e trafikut pasi që qendra e qytetit është e mbipopulluar mungojnë shumë rrugët alternative.

Në kapitullin e tretë - Ndërtimi i modelit makroskopik për qytetin e Prishtinës, Për tu bërë krijimin i modelit makroskopik në qytetin e Prishtinës ka qenë e nevojshme të bëhen disa hulumtime në lidhje me lëvizshmërinë e trafikut në zonën qendër të qyteti duke përfshirë lëvizjen e automjeteve, përfshire këtu numërimet në orën kulmore që janë realizuar në 7 hyrje dhe dalje në qytetin e Prishtinës duke përfshirë këtu Rrugët Prishtinë-Pejë, Prishtinë-Mitrovicë, Prishtinë-Podujevë, Prishtinë-Gjilan dhe rrugën Prishtinë-Hajvali, Prishtinë-Fushë Kosovë dhe Prishtinë-Gollak dhe pas këtyre numërimeve kemi vazhduar edhe me numërimin e rrugëve Tranzit.

Në kapitullin e katërt - Aplikimi i PTV VISUM, Modelet makroskopike të trafikut për krijimin e kërkesës së transportit përdoren gjerësisht në inxhinierinë e trafikut dhe transportit si dhe në vlerësimin e sistemit të planifikimit dhe projektimit të transportit, operacionet e trafikut, zgjedhjen e alternativave, parashikimet e kërkesës për transport, etj. Këto modele janë të lehta për t'u aplikuar, më efektive, më të shpejta, pavarësisht analizave dhe provave të cilat kryhen direkt në terren.

Në kapitullin e pestë -Propozimi i zgjidhjeve të mundshme bazuar në analizat e bëra, Pasi që kam paraqitur të gjitha të dhënat dhe i kam vendosur në softuerin PTV Visum kam filluar me implementimin e qarkullimit të automjeteve ku pastaj kam analizuar pikat kyçe të kryeqytetit duke përfshirë këtu zonën qendër kam arritur në përfundim të dy propozimeve të cilat në bazë të analizave të cilat i kam zhvilluar kanë rezultuar mjaft produktive duke bërë që në mënyrë shumë të thjeshtë të kemi zhbllokim të komunikacionit në pjesët kyçe të qytetit të Prishtinës.

Në kapitullin e shtatë -përfundimi , Në përfundim të këtij studimi mbi analizën dhe modelimin e kërkesës për udhëtime në qytetin e Prishtinës për qëllim të modelimit të kërkesës për udhëtime me anë të softuerit PTV Visum në qytetin e Prishtinës, janë arritur disa përfundime kryesore, të cilat reflektojnë rëndësinë e analizës së integruar dhe përdorimin e këtij softuerin në mënyrë që sa më të thjeshtë të kemi mundësinë e propozimeve si dhe të implementimeve të qarkullimit të trafikut gjithashtu edhe të ndonjë

propozimi apo edhe ndërtimi të ndonjë rruge alternative. Arritja e qëllimit të këtij punimi ka ardhur si rezultat i një hulumtimi të një teorie të gjerë dhe të aplikueshme lidhur me modelimet në fushën e transportit. Mbi bazën e njohjes që i'u bë kësaj eksperience mbi analizimin dhe modelimin e kërkesës së udhëtimeve, në përcaktimin e hapave të mundshëm se si duhej të vepronim për arritjen e qëllimit tonë, duke u bazuar në gjendjen aktuale të sistemit të transportit në kryeqytetin e Prishtinës.

Në kapitullin e tetë - Literatura, e shfrytëzuar.

PËRFUNDIM




Në bazë të shqyrtimit të punimit Master, Komisioni për vlerësim konsideron se punimi është hartuar në nivel të duhur, i shtjelluar përmes figurave dhe tabelave.

Prandaj, Komisioni për vlerësimin e punimit Master, të kandidatit BSc. Amisa Bejta me titull,

“Analiza dhe modelimi i kërkesës për udhëtime në qytetin e Prishtinës” mendon se i plotëson ë gjitha kriteret për punim Master, që ta aprovoj si punim për Master dhe ta jep në diskutim publik.

Prishtinë, 07.04.2025.

Komisioni:

1. 
(Prof. Ass.Dr.Gëzim Hoxha, kryetar)
2. 
(Prof. Ass.Dr.Arlinda Alimehaj, anëtar)
3. 
(Prof. Ass.Dr.Ramadan Duraku,mentor)

P.S.: Numri i faqeve shtohet sipas nevojës. Vendi, data dhe nënshkrimet vijnë në fund.

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE
DEPARTAMENTI KOMUNIKACION
STUDIMET MASTER



PUNIM DIPLOME

TEMA: “ANALIZA DHE MODELIMI I KËRKESËS PËR UDHËTIME NË QYTETIN E PRISHTINËS”

TOPIC: “ANALYSIS AND MODELING OF TRAVEL DEMAND IN THE CITY OF PRISHTINA”

Mentori:

Prof.Ass.Dr.Ramadan Duraku

Kandidatja:

Amisa Bejta

ID: 220808200006

Prishtinë, 2025

PËRMBLEDHJA (ABSTRAKTI)

Ky punim masteri përfshinë një hulumtim lidhur me modelimin e kërkesës për udhëtime në qytetin e Prishtinës, i cili mendoj që është më se i nevojshëm për shkak të simptomave lidhur me shfaqjen dhe përkeqësimin e parametrave të qarkullimit. Duke e ditur se qyteti i Prishtinës është në zhvillim e sipër dhe se disa pjesë ose në disa zona të cilat janë zhvilluar këto kohë e fundit duke i përfshirë këtu disa lagje të cilat janë ndërtuar me vone dhe kjo gjë ka ndikuar që shumica prej tyre nuk janë të ndara në zona të caktuara nuk janë bërë hulumtime të duhura duke përfshirë këtu anketimet të cilat do të luani një rol shumë të rëndësishëm në përditësimin e të dhënave për shumicën e lagjeve të cilat me pas do të ishin shumë lehtë që të bëhet zonimi dhe ndërtimi i modelit makroskopik me qëllim parashikimin e udhëtimeve dhe si rezultat ndërmarrjen e masave adekuate përmes procesit të mirëfilltë të planifikimit .

Gjithashtu do të hulumtojmë edhe ndërtimin e modelit mikroskopik lidhur me modelimin e trafikut/transportit, mundësia e aplikimit të softverit PTV Vision VISUM për parashikimin e kërkesës në trafik.

Me pas të dhënat të cilat i kemi marr nga hulumtimet dhe nga terreni do të vendosmi në softuerin PTV Visum ku si rezultat pastaj për qëllime të analizave në nivelin mikroskopik do të bëhet aplikimi edhe i softverit PTV Vissim.

FALENDERIME

Do të doja të shprehja falënderimet e mia të sinqerta për të gjithë ata që më ndihmuan dhe më mbështetën moralisht gjatë realizimit të këtij punimi të masterit.

Fillimisht dua të falënderoj familjen, pa ndihmën e të cilëve nuk do të arrija asnjë sukses deri më tani. Janë ata të cilët më përkrahin gjithmonë dhe më japin vullnet të vazhdoj të punoj edhe më shumë drejt dijes.

Falënderime të sinqerta do të shprehja për mentorin tim Prof.Dr.Ass Ramadan Duraku, i cili më ka ndihmuar gjatë kësaj periudhe me këshillat e tija dhe më ka motivuar për të vazhduar tutje, gjithashtu një falënderim tjetër shkon edhe për dy anëtarët e komisionit Prof.Ass.Dr.Arlinda Rrecaj dhe Prof.Ass.Dr.Gëzim Hoxha të cilët kanë qenë të gatshëm gjithmonë të më ndihmojnë në pyetjet të cilat i kam pasur gjate kësaj periudhe duke kontribuar mjaft shumë në hulumtimin e temës se masterit. Përveç këtyre falënderim i veçantë shkon edhe për Ass.Liridon Sejdiu i cili gjate gjithë kohës ka qenë në dispozicion për pyetjet që i kam bërë.

Një falënderim tjetër shkon edhe për Komunën e Prishtinës përkatësisht Drejtorin e Urbanizmit më saktësisht ekspertin e komunikacionit Makfiret Abdullahun i cili gjatë gjithë kohës ka qenë në dispozicion që të më ndihmoj në lidhje me pyetjet dhe me hulumtimet të cilat i kam bërë gjatë kohës që kam qenë në praktike. Gjithashtu falënderoj edhe kolegët e mi të Departamentit të Komunikacionit, të cilët janë bërë pjesë e punës sime gjatë numërimit dhe anketimeve për realizimin e këtij punimi.

DEDIKIM

Këtë punim u'a dedikoj në shenjë falënderimi dhe respekti familjes sime, e në veçanti të dy prindërve të mi pa të cilët do të ishte shumë e vështirë rruga deri këtu pasi që ata kanë qenë shtylla kryesore që un të jemi këtu ku jam sot duke më përkrahur në çdo vendim që unë kam marrur në çdo ulje apo ngritje që kam pasur gjatë këtyre dy vite të masterit.

Prindërit e mi janë personat të cilat më kanë nxitur gjithmonë të punoj dhe të mësoj që ti arrij synimet të cilat i kam. Pasi kjo është mundësia që gjithmonë të shpie në njohuri dhe dituri, pa të cilat nuk ka kuptim të jetosh e të mos e dish vlerën që kanë.

Jam me fat dhe shumë krenare me familjen dhe të gjithë ata që janë pjesë e jetës sime.

PËRMBAJTJA E TEMËS SË MASTERIT

PËRMBLEDHJA(ABSTRAKTI)	Gabim! Shenja e referimit e padefinuar.
1.HYRJE.....	10
1.1.OBJEKTIVAT DHE QËLLIMI I HULUMTIMIT	11
2.PËRSHKRIMI I GJENDJES EGZISTUESE	13
2.1.ZHVILLIMI I LËVIZSHMËRISË	Gabim! Shenja e referimit e padefinuar.5
2.2.METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	19
2.1.1.Metoda e mbledhjes së të dhënave në teren.....	21
2.1.2.Përdorimi i “Estimate” për numrin e punëtorëve në bizneset e vogla	22
2.1.3. Klasifikimi i bizneseve dhe numrit të punëtorëve	24
2.1.4.Metoda e Anketimit Online.	Gabim! Shenja e referimit e padefinuar.8
2.1.5.Metoda e intervistimit me anë të pytësorit.....	31
2.1.6.Numërimet e qarkullimit të automjeteve.....	37
3.NDËRTIMI I MODELIT MAKROSKOPIK PËR QYTETIN E PRISHTINËS	45
3.1.1.ROLI DHE RËNDËSIA E MODELIMIT	Gabim! Shenja e referimit e padefinuar.8
3.1.2.MODELET PËR KRIJIMIN (GJENERIMIN) E UDHËTIMEVE.....	53
3.1.3.ZONIMI.....	56
3.1.4.Zonat e Studimit.....	60
4.APLIKIMI I PTV VISUMIT.....	63
4.1.1.Dizajnimi i rrjetit rrugor në softuerin PTV VISUM.....	65
4.1.2.Zonimi dhe shënimi i zonave të transportit.....	67
4.1.3.Vendosja e konektorëve.....	68
4.1.4.Vendosja e attributeve.....	69
4.1.5.Vendosja e orës kulmore.....	70
5.PROPOZIMI I ZGJIDHJEVE TË MUNDSHME BAZUAR NË ANALIZAT E BËRA.....	73
5.1.Varianti V0.....	74
5.2Varianti V1.....	78

5.3.Varianti V2.....	80
5.4.Krahasimi i dy varianteve para dhe pas propozimeve.....	82
6.KONKLuzionet.....	85
7.PËRFUNDIMI.....	86
LITERATURA.....	87